



# KUVENDI

Revistë e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 38, Mars 2013


**17 SHKURT 2013**



**5-6-7 MARS 2013**

## Përmbajtja

17 - Shpallja e Pavarësisë së Kosovës	3
5-6-7 - 15-vjetori i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës	13
8 - GRUPI I GRAVE DEPUTETE (GGD)	14
24 - Kush është Alastair Campbell	17
Mbledhje e Komisionit për Punë të Jashtme	20
Dëgjimi publik lidhur me Projektligjin për deputetët	22
Deputetët e Kosovës marrin pjesë në punimet e Këshillit të Evropës	23
Kërkesa për kthimin e Fondit të Pensioneve të Kosovës duhet të marrë rrugë institucionale	24
Veprimtarië e Kuvendit	26
Pritje në Kuvend	29



Harta fizike e vendeve që kanë njohur pavarësin e Kosovës

# 17

## Shpallja e Pavarësisë së Kosovës Ngjarje e rëndësishme në historinë e kombit shqiptar

Përvjetori i 5-të i Pavarësisë, 17 Shkurt 2013, si ngjarja më madhështore për Kosovën dhe si një nga ngjarjet me të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar, pati një agjendë mjaft të gjerë aktivitetesh në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi bëri homazhe nderimi në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe si zakonisht një vizitë në familjen e Jasharajve e më tej me pritjet dhe aktivitetet e tjera. Ndërsa një delegacion i Kuvendit, i kryesuar nga nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti bëri nderime në varreza dhe përmendore të dëshmorëve të Kosovës



Homazh në memorialin “Adem Jashari” 17.02.2013



## Një delegacion i Kuvendit, i kryesuar nga nënkryetari, z. Xhavit Haliti bëri nderime në varreza dhe përmendore të dëshmorëve të Kosovës

Me rastin e shënimit të 5-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, një delegacion i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti, krahas udhëheqësve më të lartë institucionalë të vendit, Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, kryeministri Hashim Thaçi, kryetari i LDK, Isa Mustafa, (partia më e madhe në opozitë), si edhe ministra kanë bërë nderime në varreza dhe pranë përmendoreve të dëshmorëve në qendra të ndryshme të Kosovës. Në këto aktivitete ceremoniale, delegacioni i Kuvendit dhe personalitetet më të larta të Kosovës janë shoqëruar nga kryetarët e komunave përkatëse.



Homazh në memorialin “Adem Jashari” shkurt 2013

Nderimet për dëshmorët kanë filluar në “Kompleksi Memorial Adem Jashari” në Prekaz, me ç'rast nënkryetari Haliti dhe delegacioni që ai e udhëhiqte, ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora lulesh në Varrezat e Dëshmorëve.



Shtatorja Mujë Krasniqi Klinë



Varrezat e Dëshmorëve Gllagjan





Sali Çekaj Deçan



Shkëlzen Haradinaj Pejë



Memoriali Reçak

Më pas, janë bërë nderime dhe janë vendosur kurora lulesh pranë shtatores së dëshmorit Mujë Krasniqi në Klinë, pranë bustit të dëshmorit Shkëlzen Haradinaj në Pejë, shtatoreve të dëshmorëve Luan Haradinaj e Sali Çekaj në Deçan, në Varrezat e Dëshmorëve në Glllogjan, Landovicë dhe Reçak.

Në Prishtinë, delegacioni parlamentar ka bërë nderime dhe ka vendosur kurora lulesh pranë shtatores së dëshmorit Zahir Pajaziti dhe varrit të ish-presidentit Ibrahim Rugova.



Shtatorja Zahir Pajaziti



Varri ish presidentit Ibrahim Rugova

5 Vjetori i Pavarësisë vijon me një nga aktivitetet kryesore për Kosovën, parakalimi i trupave ushtarake të FSK-së, organizuar në sheshin kryesor të Prishtinës “Nëna Terezë”

Kjo ceremoni u ndoq nga mijëra qytetarë të Kosovës, si dhe nga personalitetet me të larta të shtetit të Kosovës, Presidenti i Shqipërisë z. Bujar Nishani dhe shumë miq të tjerë, të ftuar me këtë rast, ndihmës presidentja e Republikës Arabe të Egjiptit, znj. Pakinam Hassan Khalil El Sharkawy, si dhe kori diplomatik i akredituar në Kosovë



# Parada Ushtarake me rastin e 5 vjetorit të shpalljes së Pavarsisë



Parakalimi i trupave të FSK-së 17. Shkurt 2013






## Në kuadrin e 5 vjetorit të shpalljes së pavarësisë kryeparlamentari Krasniqi priti:

Ndihmës presidenten e Republikës Arabe të Egjiptit, znj. Pakinam Hassan Khalil El Sharkawy



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, duke i uruar mirëseardhje në Kosovë ndihmëspresidentes së Republikës Arabe të Egjiptit, znj. Pakinam Hassan Khalil El Sharkawy, në këtë ditë të shënuar të pesë vjetorit të pavarësisë së vendit, ka vlerësuar marrëdhëniet shumë të mira kulturore dhe historike ndërmjet dy popujve, të cilat, është shprehur i bindur se do të zgjerohen edhe në sferën politike dhe ekonomike ndërmjet dy vendeve .

## Kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli



Para fillimit të seancës solemne, për nder të 5-vjetorit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga dy nënkryetarët z. Xhavit Haliti dhe z. Sabri Hamiti, ka pritur në një takim të veçantë kryetaren e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Jozefina Topalli e shoqëruar nga një grup deputetësh.

Kryeparlamentari Krasniqi i uroi kryetares Topalli, mirëseardhjen në Kuvendin e Kosovës duke vlerësuar 17 Shkurtin, një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e kombit shqiptar.

## Kryetarin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Rama



Në kuadër të takimeve të veçanta me të ftuarit në seancës e sotme solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryetari, dr. Jakup Krasniqi ka pritur në takim kryetarin e Partisë Socialiste të Shqipërisë, z. Edi Rama.

Kryeparlamentari Krasniqi dhe kryesocialisti shqiptar, Rama, pasi shkëmbyen urimet për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, vlerësuan të arriturat e deritashme, por shtruan nevojën e një bashkëpunimi më të thellë ndërmjet dy vendeve, në kapërcimin e sfidave të përbashkëta dhe në rrugën e integritimeve euro-atlantike.

## Seancë Solemne me rastin e 5 vjetorit

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në nderim të 5 - vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, mbajti një seancën solemne të cilën e kryesoi kryeparlamentari dr. Jakup Krasniqi. Të pranishëm në këtë seancë ishin presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, deputetë, kabineti qeveritar si dhe udhëheqës të tjerë të lartë të institucioneve shtetërore. Miq të ftuar në këtë seancë ishin Presidenti i Shqipërisë z. Bujar Nishani, kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë znj. Jozefina Topalli, deputetë dhe përfaqësues të opozitës të Shqipërisë, përfaqësues nga Maqedonia Lugina e Preshevës dhe përfaqësues të lartë të korit diplomatik të akredituar në Kosovë.

Pas intonimit të himnit, mbledhjen solemne të Kuvendit, në shënim të përvjetorit të pestë të shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës e hapi kryekuvendari dr. Jakup Krasniqi.

Me këtë rast ai tha se pas përpjekjeve e luftërave gati njëshekullore për liri dhe duke mbyllur kapitullin historik të robërisë e të gjenocidit, Kosova më 17 shkurt 2008, me koordinim ndërkombëtar, u shpall shtet i pavarur, sovran dhe demokratik. "Plaga e rëndë ballkanike, e quajtur çështje e Kosovës, pushoi së rrjedhuri gjak. Padrejtësia e madhe historike e vitit 1913, ndonëse me vonesë, u ndreq. Pesë vjet s'mund të bëjnë veç një jubile i vogël, por i një ngjarjeje të madhe dhe historike që po shënojmë sot. Drejtësia e luftës dhe e përpjekjeve tona të gjata, idealet e larta që i udhëhoqën ato, i dhanë shumë shpejt legjitimitet ndërkombëtar Pavarësisë së Kosovës, si shtet i ri, i lirë, sovran dhe demokratik, "tha kreu i Kuvendit, duke shtuar se pavarësia e Kosovës përbën një fakt tashmë të pamohueshëm dhe të pakthyeshëm historik, politik e diplomatik.



Pamje nga seanca solemne

### Fjala e Kryeparlamentarit Krasniqi 17 Shkurt 2013

Më tej kryeparlamentari Krasniqi tha se në historinë dhe jetën e një vendi, pesë vjet nuk janë aq shumë, por të arriturat dhe ndryshimet që ka bërë Kosova në epokën e Pavarësisë janë të mëdha, sidomos drejt ngritjes së institucioneve shtetërore e demokratike, drejt fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar dhe zhvillimit të gjithanshëm shoqëror e ekonomik, sepse vetë akti i pavarësisë, ka çliruar energji kolosale dhe entuziazëm veprimi e përparimi. "Në Kosovë është vendosur rend kushtetues që bazohet në parimet e lirisë, paqes e demokracisë. Kosova, me kushtetutë i ka sanksionuar sistemin politik demokratik, sovranitetin e popullit, pluralizmin politik dhe ekonomik, parimet e demokracisë parlamentare, zgjedhjet e lira dhe të drejta, qeverisjen e shtetit të së drejtës, ndarjen dhe kufizimin e pushteteve, sigurimin dhe garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe procedurat demokratike. E drejta kushtetuese në Kosovë bazohet në parimet dhe vlerat moderne të demokracisë së avancuar. Të drejtat e liritë e

njeriut dhe të komuniteteve pakicë në Kosovë sigurohen sipas standardeve më të larta ndërkombëtare dhe në përputhje me pakon e presidentit Ahtisaari. Kosova ka një rrjet të tërë të organizatave të pavarura të shoqërisë civile, aktive dhe me kapacitete për të marrë pjesë në proceset demokratike. Janë bërë gjithashtu përparime në fushën e lirisë së mendimit e të shprehjes dhe të zhvillimit të lirë të medias së shkruar e elektronike", tha kryeparlamentari Krasniqi.

Ai duke përmendur si rezultat të përparimeve të gjithanshme, përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, tha se megjithatë duhet të jemi të ndërgjegjshëm se nuk kemi asnjë arsye për vetëkënaqësi, duke pasur parasysh mundësitë dhe potencialet njerëzore e resurset e shumta natyrore të pashfrytëzuara, të cilat mund ta kishin vendosur vendin tonë gjatë kësaj periudhe në një stad më të lartë zhvillimi e përparimi.





Fjala e kryeparlamentarit Krasniqi

"Ne nuk mund ta ndryshojmë as ta harrojmë historinë, por mund të ndërtojmë bashkë një të ardhme tjetër, paqësore e në miqësi, për gjithë brezat e vendeve tona, duke lënë pas konfliktet dhe luftërat shkatërruese. Kosova gradualisht e ka forcuar subjektivitetin e saj ndërkombëtar, duke u pranuar anëtare e FMN-së, BB-së e BERZH-it dhe duke marrë pjesë në shumë forume rajonale e ndërkombëtare të bashkëpunimit. Por Kosova ende nuk është pjesë e barabartë e projekteve dhe iniciativave të bashkëpunimit e të integritimeve rajonale. Ajo, pa të drejtë mbahet jashtë Këshillit të Evropës, jashtë OSBE-së, jashtë IPU, por edhe jashtë OKB-së e organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Kosova është subjekt ndërkombëtar, prandaj sillet në përputhje me parimet e njohura demokratike dhe konform të drejtës ndërkombëtare. Ajo i njeh dhe i ka adoptuar parimet e dokumenteve të OKB dhe po jep kontributin e saj për paqen dhe

marrëdhëniet ndërkombëtare. Bazuar në këto parime dhe në interesat tona të ndërsjella, ne kemi ndërtuar marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me të gjitha vendet që na rrethojnë, përveç Serbisë, e cila nuk i është përgjigjur dorës sonë të zgjatur", tha kreu i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi duke shtuar më tej se Republika e Kosovës është gati t'i normalizojë marrëdhëniet, sikur me të gjithë fqinjët edhe me Serbinë, por jo në dëm të integritetit territorial, të sovranitetit dhe të rendit kushtetues të vendit tonë.

Duke përmendur dialogun me Serbinë, ai tha se duke qenë ndërmjetësues në këtë dialog Bashkimi Evropian, shpresojmë që do të ushtrohet ndikim pozitiv mbi autoritetet serbe, për të hequr dorë nga strukturat kriminale të instaluara në veri të Kosovës, për t'i hapur rrugë veprimit efikas të institucioneve tona e të EULEX dhe për të bërë të mundur zgjedhjen e përfaqësuesve nga vetë qytetarët atje.



Trupa diplomatike dhe miq të tjerë të ftuar

"Ashtu si në të kaluarën, Kosova do të jetë në partneritet të plotë me bashkësinë ndërkombëtare në synimin e saj për një shoqëri dhe shtet demokratik, të anëtarësuar në OKB e në organizmat e tjerë ndërkombëtarë dhe të integruar në Bashkimin Evropian e në NATO. Kosova është në proces të forcimit të sundimit të ligjit dhe në luftë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke pastruar rrugën drejt një shteti të vërtetë ligjor, demokratik dhe të integruar në Evropën e Bashkuar. Një pengesë serioze për marrëdhëniet e Kosovës me Bashkimin Evropian përbën fakti i mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga pesë vende të Bashkimit Evropian. Ne presim që edhe këto vende do të reflektojnë

për qëndrimet e tyre, duke njohur pavarësinë e Kosovës dhe duke i hapur vendit tonë mundësinë e plotë të marrëdhënieve kontraktuale me BE-në dhe zhvillimin normal të procesit të integritimeve evropiane të tij. Përshtendës në këtë rast Rezolutën e Parlamentit Evropian, të para dhjetë ditëve, me të cilën u bëhet edhe njëherë thirrje këtyre pesë vendeve të BE, ta njohin pavarësinë e Kosovës. Fitorja e luftës për vendosjen e rendit dhe ligjit, fitorja e luftës kundër krimit e korrupsionit, është njëkohësisht fitore e luftës kundër varfërisë e papunësisë, sepse vetëm kështu hiqen barrierat e investimeve dhe bizneseve, vetëm kështu hapet perspektiva ekonomike dhe sociale e Kosovës.



Pamje nga salla 17 Shkurt 2013

Sot është dita e dëshmorëve dhe e lirisë që na sollën me gjakun e tyre, dita e themeluesve e baballarëve të shtetit të Kosovës, në krye me heroin legjendar, komandantin Adem Jashari. Lavdia e tyre, si gjerdan lirie do të stolisë përjetë ballin e Kosovës.

Midis nesh në këtë sallë ndodhen përfaqësues diplomatikë të shumë vendeve mike të Republikës së Kosovës. Populli ynë mirënjohës, kurrë nuk do të harrojë solidaritetin e botës demokratike dhe

humane, mbështetjen e pakursyer të miqve tanë të shtrenjtë, në krye me SHBA, BE dhe NATO-n, në çastet më të vështira historike që po kalonte vendi ynë. Gjej këtë rast, që në emër të Kuvendit, qytetarëve që përfaqësojmë dhe timin personalisht, t'u dërgoj përshëndetjet vëllazërore dhe falënderimin e përjetshëm për gjithë mbështetjen dhe miqësinë që na dhanë e po na japin, vende e popuj në katër anët e globit", tha me këtë rast kreu i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi.



Presidentja Atifete Jahjaga

Në fjalën e rastit, presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, tha se shpallja e pavarësisë së një vendi nga ata që përfaqësojnë qytetarët e tij, është akti më madhor, është vepra më fisnike dhe më e lartë. "Ky është hap që siguron të ardhmen e qetë dhe të përparuar të qytetarëve të vendit dhe gjithë vendos bazën e zhvillimit e të mirëqenies së tyre. Historia e pavarësisë së shtetit tonë të përbashkët është e re. Ajo është pjesë e secilit qytetar të Kosovës dhe e secilës gjeneratë. Është hap madhor në vendosjen e paqes dhe të stabilitetit dhe në forcimin e sigurisë e të partneritetit jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Për më shumë, është hap konkret i mirëkuptimit mes nesh - Qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është shtet i miqësisë së përjetshme me SHBA-në dhe i partneritetit me vendet e BE-së, " theksoi presidentja Jahjaga.

Ajo më tej shtoi se në këto pesë vite të shtetësisë, Republika e Kosovës ka ngritur institucionet e saj demokratike dhe funksionale, institucione gjithëpërfshirëse, me angazhim të vazhdueshëm për mirëqenien e qytetarëve të vendit dhe për të ardhmen e tyre.

"Në këtë pesë vjetor ne kemi shumë arsye për të festuar por edhe më shumë punë për të bërë për të vendosur themelet e fuqishme të zhvillimit dhe të përparimit. Shteti që po ndërtojmë bazohet mbi platformën e shtetit të së drejtës, ku sundimi i ligjit dhe rendi janë shtyllat themelore të tij. Ky shtet ligjor, me një sistem të reformuar të drejtësisë, do të hapë dyert e përparimit dhe të integritetit në familjen evropiane, si dhe do të ndihmojë zhvillimin e ekonomisë së tregut. Por, ne duhet të thellojmë luftën tonë kundër dukurive negative, krimit të organizuar e korrupsionit dhe duhet të dëshmojmë se atë mund ta fitojmë" theksoi presidentja Jahjaga.

"Bashkimi Evropian është synim yni.

Kjo është alternativa e vetme që kemi dhe rruga drejt tij është e pandalshme dhe e pamohueshme. Perspektiva jonë e integritetit evropian është e qartë dhe atë do ta kalojmë të gjithë së bashku - Ne Qytetarët e Republikës së Kosovës. Rruga drejt familjes evropiane, e të gjithë neve, shteteve të vogla të Ballkanit Perëndimor do të jetë më e lehtë dhe më e sigurt vetëm duke e ndihmuar njëri-tjetrin.

Zgjidhjet i kemi kërkuar vetëm përmes dialogut, si mënyrën më të mirë për të arritur rezultate që bazohen në përvojat dhe standardet evropiane dhe që respektojnë integritetin e secilit shtet" tha mes tjerash presidentja Jahjaga.





Kryeparlamentarja  
e Shqipërisë  
Jozefina Topalli

Kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Jozefina Topalli, duke uruar festën e Pavarësisë së Kosovës, tha se ndjehet shumë e lumtur që është në Kosovë dhe ka mundësinë që të flas përpara parlamentit të Kosovës së lirë, të pavarur e demokratike.

"Në këto 150 vitet e fundit, në 100 vitet e fundit, në 50, në 15 vitet e fundit Ju nuk u nënshtruat kurrë, nuk u ndalët një herë. Shqiptarët këtu, shqiptarët në Maqedoni, shqiptarët në Mal të Zi, shqiptarët në Shqipëri nuk humbën kurrë besimin, nuk shuan kurrë shpresën, edhe pse të copëtuar, edhe pse nën pushtim, edhe pse nën diktaturë, edhe pse dukej e pamundur, për shqiptari, për Liri.

Prizrenit, ata që u ngritën, ata që filluan, organizuan, e bënë kryengritjet e mëdha, ata bënë aq shumë për Shqipërinë e lirë e të mosvarme.

Pa të madhin Hasan Prishtina, pa Isa Buletinin-Robin Hudin shqiptar, nuk do kishte Shqipëria 100 vjet pavarësi, e pa këtë te fundit vështirë të ishim sot duke kremtuar së bashku. Dhe për këtë, në emër të Kuvendit të Shqipërisë dua të falënderoj Kosovën dhe shqiptarët e Kosovës. Faleminderit Kosova!

Sot nderojmë çdo shqiptar në Kosovë, çdo familje në Kosovë që kombin e lirinë e kishin sublime, e kishin më të shtrenjtë se jetën e tyre, më të çmuar se pasurinë e tyre, më të madhe se ëndrrat e tyre. Me përulje e mirënjohje, sot kujtojmë e nderojmë Presidentin e parë të Kosovës, Ibrahim Rugovën. Arkitektin e Kosovës së pavarur. Nderojmë besimin e tij të palëkundur tek paqja, përkushtimin, punën, maturinë e vendosmërinë për lirinë, për Kosovën. Sot nderojmë veprën e tij.



Pamje nga  
seanca solemne  
17 Shkurt 2013

Në këtë ditë historike, nderojmë Luftën Çlirimtare të Kosovës, luftëtarët e lirisë, martirët e saj, e mbi të gjithë legjendën shqiptare të saj, Adem Jasharin. Ai është vetë shqiptaria, zjarri i dashurisë e flijimit për këtë tokë, për këtë dhe, për këtë komb.

I përjetshëm nderimi dhe kujtimi i tij" tha kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Jozefina Topalli. Ajo shtoi se ne nuk festojmë vetëm 5 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës së lirë, ne nuk festuam vetëm 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë së dashur. Ne kremtojmë ndryshimet e mëdha që Kosova ka bërë, që Shqipëria ka arritur.

«Ne jemi krenarë që jemi shqiptarë, e krenarë që

jemi evropianë. Ne duam t'i bashkohemi Komunitetit Evropian t'u ngritur mbi vlerat universale. Ne të gjithë bashkë kemi vetëm një objektiv. Një komb një qëndrim është besimi ynë. Një komb një qëndrim ishte motoja jonë në ditë të vështira. Një komb një qëndrim është aktual sot. Një komb një qëndrim do jetë për jetë të jetëve. Ne duam të integrohemi në Bashkimin Evropian. Ne duam të bashkohemi me njëri-tjetrin. Ne duam të bashkohemi me familjen evropiane.

Ne do të vazhdojmë të bëjmë punën e madhe që kërkohet për të hyrë në BE. Ne në Shqipëri, Ju në Kosovë, shqiptarët në Maqedoni, shqiptarët në Mal të Zi", tha kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli .



Kryeministri Hashim Thaçi

Në fjalën e tij kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi tha se para pesë vitesh, këtu, në këtë Kuvend, u kurorëzua ëndrra shekullore e qytetarëve tanë, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës. "Më 17 shkurt 2008 u themelua shteti i Kosovës me aktin më të lartë historik, juridik dhe politik, me Deklaratën e Pavarësisë, pra Kosova shtet i pavarur dhe sovran. Deputetët e Kuvendit të Kosovës aprovuan Dokumentin më të rëndësishëm historik të Kosovës. Më lejoni të përshëndes deputetët firmëtarë të pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës para së gjithash e firmosën dhe e vulosën dëshmorët e lirisë, sakrificave dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më 17 shkurt 2008 në gjeografinë politike të Evropës u lind një shtet i ri. Më 17 shkurt 2008 Kosova mori atributin më të lartë të organizimit politik, krijimin e shtetit të pavarur. Më 17 shkurt 2008 Kosova institucionalizoi organizimin më të lartë shoqëror, shtetësinë e saj.

Ky akt madhështor, origjinal dhe i papërsëritshëm i vullnetit të popullit ishte kryevepër e synimeve, idealeve, përpjekjeve dhe sakrificave të vazhdueshme të gjeneratave të tëra. Por, këtë akt të jashtëzakonshëm e bëri madhështor fakti që u njoh, u mbështet dhe u përkrah nga shtetet më të rëndësishme të demokracisë botërore. Pavarësia e Kosovës u njoh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, dhe shtete tjera demokratike anembanë botës, theksoi kryeministri Thaçi duke shtuar se brenda një periudhe pesëvjeçare Kosova ka shënuar hapa të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve.

Që nga shtatori i vitit që shkoi Kosova hoqi Mbikëqyrjen e Pavarësisë suksesshëm, duke u bërë shtet me përgjegjësi të plotë për veten dhe ardhmërinë e saj. Kosova hoqi mbikëqyrjen pas një vlerësimi të lartë gjithë ndërkombëtar për suksesin në Kosovë. Brenda një periudhe të shkurtër Kosova ka shënuar rezultate të lakmueshme në të gjitha fushat.

Kosova ka shënuar rritje ekonomike dhe zhvillim të infrastrukturës, duke përmirësuar standardin e jetesës për të gjitha kategoritë shoqërore. Kosova është njohur nga rreth 100 shtete", theksoi kryeministri Thaçi duke shtuar se presim shumë shpejt edhe njohje të reja. Ai theksoi se Kosova është në rrugë për përmbushjen e kritereve për t'u anëtarësuar në institucionet euroatlantike në BE, NATO, dhe në rrugën drejt anëtarësimit në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. "Natyrisht, në tërë këtë proces, Kosova do të ballafaqohet me sfida, por jam i bindur se politika kosovare, bashkërisht dhe në koordinim të ngushtë me miqtë ndërkombëtar do t'ia arrijmë të realizojmë këto synime.", tha kryeministri i vendit, Hashim Thaçi



Pamje nga seanca solemne 17 Shkurt 2013



# 5-6-7

## 15-vjetori i Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

*Në kuadër të shënimit të 15-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, i drejtuar nga dr. Jakup Krasniqi, kryetar, është mbledhur sot në seancë, duke nderuar dhe përkujtuar luftën heroike dhe rënien e Komandantit Legjendar Adem Jashari e të familjes Jashari.*



Pamje nga salla



Deputeti i VV, Rexhep Selimi

Në cilësi të përfaqësuesit të iniciuesit të kësaj mbledhjeje, deputeti Rexhep Selimi tha se popujt dhe kombet kanë historitë e tyre, luftuan dhe vazhdojnë të luftojnë ende për liri, kanë bërë sakrificë të mëdha, por, nuk ka komb në botë ta ketë një Adem Jashar dhe një Familje Jashari, ashtu siç e ka kombi shqiptar.

"Sot, ne nuk do të mund të flisnim për luftën për liri pa Adem Jasharin, por as ta paramendonim Adem Jasharin pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ishte veç ushtria e tij, por edhe lufta e tij. Le të ruhet dhe të nderohet UÇK-ja si vlerë historike e kombit. Aty ku ruhet sot UÇK-ja si vlerë e kombit qëndron edhe porosia e Jasharajve, porosia e Adem Jasharit. UÇK-ja si vlerë dhe si histori nuk mund të shihet ndaras nga porosia e Adem Jasharit për liri e për bashkim", theksoi deputeti Selimi. Ai shtoi se këto 15 vite është dëgjuar shumë shpesh të flitet për ngjarje historike, për vendime dhe arritje historike. Secila prej tyre, theksoi Selimi, e ka provën e vërtetësisë, e ajo është përputhja ose jo me realen e prodhuar nga akti historik që mban shenjë Jasharaj.

Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, në fjalën e tij tha se ky manifestim, me të drejtë e mban emrin Epope, sepse shënon sakrificën supreme të Jasharajve, që sublimuan vetëdijen politike dhe shpirtin liridashës të të gjitha kohëve, për Kosovën e lirë, të pavarur dhe moderne. Thaçi tha se tri ditët e Epopesë, sintetizuan rrugën e gjatë historike të qëndresës dhe të luftërave të drejta të brezave, për çlirimin e Kosovës nga okupimi shekullor. Gjatë tri ditëve të Epopesë së UÇK-së, shtoi më tutje kryeministri, u sfidua historia dy mijë vjeçare e civilizimit shqiptar.

"Historia e Kosovës po përballë me makinën shekullore të sundimit të Kosovës. Dëshmorët e lirisë u flijuan për ëndrrën e të gjithë brezave, çlirimin e Kosovës. Rënia e Jasharajve, në krye me Komandantin Legjendar Adem Jashari, hap kapitullin më të madh të zgjerimit dhe rritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja, me një bazë të gjerë popullore, ishte niveli më i lartë i organizimit politik-ushtarak që e kishte prodhuar ndonjëherë lëvizja atdhetare e Kosovës. Shumë shpejt, UÇK-ja do të bëhej projekti më serioz që artikuloi kërkesat politike dhe interesat strategjike të Kosovës në periudhën 1992-1999", theksoi ndër të tjera kryeministri Thaçi.

Në emër të Kuvendit, kryetari Jakup Krasniqi tha se kjo seancë nderimi e përkujtimi i detyrohet një ngjarjeje të madhe që kur e kur u quajt betejë, kur e kur luftë, kur e kur epope. Në cilindo variant që ta marrim, shtoi kryetari Krasniqi, nuk mungojnë përcaktorët, Prekazi - Adem Jashari - Jasharët - Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

"Si kur themi Beteja e Prekazit, si kur themi Lufta e Prekazit, po ashtu edhe kur themi Epopeja e Prekazit, Epopeja e Adem Jasharit apo Epopeja e UÇK-së, në kujtesën tonë rikthehet pesë, gjashtë dhe shtatë marsi i vitit 1998 - hapja e faqes më të re të historisë, hapja e epokës së re që na e solli pavarësinë, sovranitetin, demokracinë të formalizuar më 17 shkurt 2008", tha në fjalën e tij kreu i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari Krasniqi tha se emri dhe kulla e Adem Jasharit nuk kishin të bënin me folklorizmin, po me akademinë e atdhedashurisë, ku Legjendari ynë mësoi vendosmërinë e gatishmërinë për t'u përballur me të keqen, robëruesin, vdekjen, pavarësisht tagrit e çmimit.

"Si i tillë, ai u bë pritësi dhe mbështetësi i të gjithë luftëtarëve anekënd Kosovës e trojeve të tjera etnike shqiptare", theksoi ndër të tjera kryeparlamentari Krasniqi

# 8

## GRUPI I GRAVE DEPUTETE (GGD) - Shembull i mirëkuptimit, tolerancës, zhvillimit, konsolidimit dhe emancipimit të shoqërisë kosovare



GGD në Kuvend

Grupi i Grave Deputet u formua me 5 korrik 2005 me rastin e vizitës së ish sekretares së SHBA-ve znj Medelin Albright në Kosovë. Atëherë u quajt Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës.

Më pastaj me një vendim unanim të deputeteve ndërroi emrin në Grupi i Grave Deputete-GGD. GGD është grup shumë aktiv e cila përbëhet nga të gjitha gratë deputete nga të gjitha grupet parlamentare dhe të gjitha nacionaliteteve. GGD ka kryetare znj. Teuta Sahatçia, e zgjedhur me

shumicën e votave të deputeteve dhe Bordin e GGD-ës me nga një përfaqësuese të secilit grup parlamentar.

Ne pretendojmë zhvillim të mirëfilltë demokratik, ekonomik, kulturor duke siguruar pjesëmarrje të barabartë të dy gjinive ky edhe është kontributi dhe roli ynë në objektivat e Zhvillimit të Mileniumit (OZHM) dhe në përmbushjen e objektivave që dalin nga Plani i veprimit për partneritet Evropian (PVPE).

GGD tashmë ka krijuar fizioniminë e vet duke e pasuruar vazhdimisht me aktivitete të shumta. Zëri i GGD-së ndihet i plotë



GGD në Kuvend

në parlament:

- Seanca parlamentare e veçantë më temën: "Pozita e gruas në shoqërinë kosovare", "Apel kundër dhunës në familje" Propozim-amandamente, në favor të përfshirjes së gruas në: "Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës". - Pjesëmarrja e përfaqësueseve të GGD në grupe punuese: si Grupi për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe Grupi për Reformën Zgjedhore.

Reagimi për listën një gjinore të propozimeve për ambasador që rezultoi me emërime edhe të grave në këto poste.

Aprovohet Rezoluta "Partneriteti për Ndryshim-Fuqizimi i Gruas,-Parimet e Prishtinës: 2050-50 Përfshirja e përfaqësueseve të GGD-së në delegacionet e Kryesisë së Kuvendit në takime në Kuvend dhe vizita jashtë.



## në Konferenca, Tryeza pune dhe takime



Pamje nga samiti

- Samiti i Gruas – me organizim të presidencës, ku GGD kishte rol aktive në këtë Samit, në panelet Java e Gruas (NDI, USAID, Ambasadat)  
- Ndarja e 11 mirënjoheve nga GGD:- Presidentes së Kosovës Atifete Jahjaga, krye parlamentarit Jakup Krasniqi, Besarta Jasharit (nga familja Jashari); postmortum, deputetes Nekibe Kelmendi, këngëtares Nexhmie Pagarusha, aktore Safete Rugova, publicistes Sanije Gashi, dhe gazetari e poetit Halil Matoshi, veprimtareve nga Serbia, Natasha Kandiç dhe Sonja Biserko, afaristes Dhurata Bardoniçi

- Konferenca dyditore në bashkëpunim me OSBE – “Gruaja në Vendimmarrje”.  
- Konferenca në Bibliotekën Kombëtare (QTSGJ). Kuota Gjimore-përfaqësimi i barabartë për gratë në Kosovë.  
- Takim me fëmijët jetim në , SOS fshatin e Fëmijëve. Takim me Strehimoren për fëmijë “Shpresa”

## në bashkëpunime



Në bashkëpunim me NDI janë mbajtur Tryezat: Reforma zgjedhore ; Dhuna në Familje; Gratë në Biznes me temën “Pse Gratë kanë nevojë për Gratë; Kanceri në Gji dhe Qafë të Mitrës; Mediat dhe Portretizimi i Gruas në Media. Tryezat: Buxheti gjinor në nivel lokal janë mbajtur në komunat: Gjakovë, Gjilan , Shtërpce dhe Vushtrri  
Me UNDP: Gruaja dhe qasja e sajë në drejtësi; Pronësia për Mbrojtjen e burimeve të gazetarisë-rëndësia dhe nevojat; Të drejtat pronësore të gruas qasja në resurse.  
Me Odën Ekonomike të Koblençit të Gjermanisë: Zejtaria Mundësi Punësimi për Gratë  
Në Universitetin e Prishtinës: Tryezë: Përfaqësimi i Gruas së UP, në vendimmarrje në strukturat udhëheqëse të Universitetit  
UNWOMEN- tryeza dhe konferenca: për ditën e

hapjes“Ditët e Hapura Globale për Gratë, Paqen dhe Sigurinë”.  
GGD merr pjesë në punimet e Kongresit të pestë të “Kongresi i 5-të i gruas shqiptare mbarëkombëtare”  
Në bashkëpunim me USAID-DEMI, Tryeza: Roli i Gruas në Qeverisjen Lokale, në komunat: Kamenicë, Kaçanik, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Vushtrri dhe Fushë Kosovë, Gjilan, Shtërpçë, Ranillug, Graçanicë, Partesh, Novobërdë dhe Kllokot, Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Suharekë dhe Mamushë  
Në bashkëpunim me Friedrich Ebert Stiftung dhe Top Radio, Tryeza; “Reforma Zgjedhore dhe Fuqizimi i Gruas” në komunat: Gjakovë, Pejë, Istog, Gjilan, Prizren, Klinë, Suharekë, Ferizaj, Vushtrri, Deçan, Ferizaj, Kamenicë, Dragash, Mamush  
Në bashkëpunim me OSBE: me gratë e komunave të Prishtinës, Graçanica, Obiliç, Fushë Kosova, Lipjan, Shtimje, Ferizaj, Podujeva dhe Peja.

në pjesëmarrje, konferenca dhe tryeza ndërkombëtare si dhe takime diplomatike



Takime me - Raportuesen për Kosovën në BE, znj. Ulrike Lunacek, Deputeten e Parlamentit Evropian, znj. Doris Pack, me Guvernatorin Howard Dean anëtar i Bordit të NDI, GGD presin një delegacion nga Bundestagu i Gjermanisë kryesuar nga Inge Hoyer, Shefin e zyrës së BE-së në Kosovë, z. Samuel Zbogor. Eksperten nga SHBA-ja, znj. Juli R Weeks, e cila njëherësh është presidente dhe kryeshefe e "Womenable" Deputeti i Bundestagut z. Juratovic, Delegacionin, 7 anëtarësh të deputetëve të Parlamentit të Suedisë në përberje edhe deputeti suedez me prejardhje nga Kosova Adnan Dibrani. Delegacioni kryesohej nga Jonas Gunnarson Delegacionin prej 20 anëtarësh të nga pesë vendet Evropiane të cilat ende nuk e kanë njohur ende Kosovën, kryesuar nga Ignacio Molina.

Kongresistët e SHBA: z. David Dreir, z. David Price, z. Jim Mc Dermott, z. Erik Paulsen dhe z. Gerry Connelly...

Takimi me Ambasador të akredituar në Kosovë: SHBA, Mb e Bashkuar; Francez, Gjerman, Italian, Holandez, Zvicerane, Suedeze, Turke etj. Takim organizuar nga Këshilli Britanik me studentë nga MB të cilët kanë prejardhje nga vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Takim me një delegacion nga vendet e Amerikës Latine

### **Pjesëmarrje :**

Kryetarja e GGD Teuta Sahatçia, përfaqëson Evropën në Konferencën në Akra të Ganës, me temën:- "Vendosja e kontekstit: Strategjitë për përsheptimin e qasjes së gruas në leadership dhe vendimmarrje" Deputetet e Parlamentit të Kosovës marrin pjesë në një seminar në Kongresin Amerikan Kryetarja e GGD znj. Teuta Sahatçia dhe deputetja Alma Lama, morën pjesë në konferencën "Forcimi i strukturave parlamentare të grave deputete në rajonin e OSBE-së, të mbajtur në kryeqytetin e Austrisë, Vjenë. Kosova ishte ftuar për të ndarë eksperiencën pozitive të Grupit të Grave Deputete

### **Bashkëpunim rajonal**

Konferenca në Shqipëri, Tryeza në bashkëpunim me deputete nga Shqipëria. Roli i Gruas -100 vjet shtet u mbajt në prag të 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë Konferenca me karakter regional me ABGJ me temën "Roli i Gruas në Proceset Integruese", Deputetet dhe aktiviste nga Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi ftohen dhe marrin pjesë në "Java e Gruas" dhe tryezat e organizuara nga GGD. Deputet marrin pjesë takimin regional në Budva

**Aktivitete** në favor të përmirësimit të pozitës së gruas: Mbrëmja humanitare për blerjen e aparaturës Ma-Mo

Fushata kundër kancerit të gjirit Në përkrahje nga UNDP-Ekspozita e Piktoreve të Kosovës në Hollin e Kuvendit me temën "Gruaja dhe Arti" me qëllim të përkrahjes së aktivitetit të GGD për blerjen e mamografit mobil



## Kush është Alastair Campbell



Njeriu që përdori në mënyrë të përkryer pushtetin e mediave për të fituar miratimin e publikut, për fushatën e bombardimeve të NATO-s në Serbi

Alastair John Campbell u lind më 25 Maj 1957. Ai është një gazetar Britanik, transmetues ndihmës politikan dhe autor, i mirënjohur për punën e tij si Drejtor i Komunikimit dhe Strategjisë pranë kryeministrit Tony Blair gjatë periudhës 1994-2003



Alastair Campbell, njeriu që ka qëndruar 10 vjet me radhë në krah të kryeministrit britanik, ka botuar katër volume ditarësh të tij gjatë kohës që ka qëndruar pranë Tony Blair. “Vitet me Tony Blair” (The Blair Years) është një përmbledhje e asaj çfarë ka ndodhur gjatë periudhës 1994 - 2003.

Për lexuesin kudo shqiptar, konflikti i Kosovës që pasqyrohet i zgjeruar në volumet II dhe III është një interes i jashtëzakonshëm, që duhet vlerësuar, mësuar dhe studiuar.

Nuk i bëjmë nder Alastair Campbell duke e mbushur Kosovën me librat e tij, por Kosova do të vazhdojë të përfitojë nga vepra e Alastair Campbell.

Ditari i Campbell është një libër i vlerave pa limit:

- Për historianët kosovarë është një dokument i çmuar, ku zbardhen mënyrat sesi udhëheqësit e botës marrin vendimet pas dyerve të mbyllura.

- Libra plot vlerë për politikën dhe politikanët, si një manual i domosdoshëm për të njohur , presionin që ndiejnë personalitetet ndërkombëtare dhe vendosmërinë e treguar në momentet, kur bëjnë zgjedhje, që prekin fatet e miliona njerëzve.

- Për gazetarët dhe studentët është një margaritar në lëmin e komunikimit si dhe të marrëdhënieve me publikun dhe strategjisë politike. Një rrëfim i jashtëzakonshëm kur kryetarët e qeverive debatojnë për vendim marrjen dhe impaktin, që qeverisja e një kryeministri apo një tjetri ka në mënyrën sesi i zgjidh çështjet, kur është në presion



Alastair Campbell ka ushtruar postin e zëdhënësit dhe Drejtorit të Komunikimit dhe Strategjisë, (1994-2003) por që për të shpesh thuhej se ishte pikërisht ai që lëvizte fije të shumta brenda qeverisë që drejtohej nga kryeministri Tony Blair. Sot, Alastair Campbell është njeriu i cilësuar si mbreti i spin-it. Ai ftohet shpesh në auditorë të ndryshëm në mbarë botën për të dhënë leksione mbi artin e marrëdhënieve publike dhe menaxhimin e krizave.

Alastair Campbell për ngjarjet në Kosovë është dëshmitari kyç i një lufte që nuk kishte miratimin

e të gjitha vendeve evropiane. Në krijimtarinë e tij, ai zbulon sesi e përdori pushtetin e medias për të fituar miratimin e publikut për fushatën e bombardimeve të NATO-s në Serbi. Vetë Campbell është i bindur se aleatët perëndimorë morën vendimin e duhur për t'i dhënë fund vrasjes së njerëzve të pafajshëm në Kosovë.

Ai përshkruan edhe përpjekjet dhe zellin për t'u urdhëruar bombardimet teksa bashkëbisedonte me refugjatët kosovarë në kampet e improvizuara në

ditët kur situata dukej e vështirë për t'u zgjidhur, madje gati e pamundur. Ai hedh dritë edhe për qëndrimin e disa udhëheqësve të Bashkimit Evropian kur duhej vendosur ndërhyrja ushtarake.

Campbell-it iu kërkua nga Clinton dhe Blair të vendosej në Bruksel gjatë bombardimeve të NATO-s, për të "rregulluar" problemet që kishin raportimet mediatike gjatë luftës së Kosovës.

Shqiptarët përfituan nga pasioni i tij për jetën dhe këmbëngulja për të luftuar të keqen.

## Fragmente nga ditari "Vitet me Tony Blair"



E mërkurë, 24 mars Berlin.

Kosova vazhdonte të ishte lajmi kryesor. E kalova një pjesë të pasdites duke punuar për daljen televizive të Tony Blair (T. B) për Kosovën. John Sawers më mori mënjandë dhe tha se Kosova do bëhej patjetër dhe aksioni fillonte në 7 të darkës. SACEUR (Komandanti Suprem i Aleancës për Evropën, Gjenerali Wes Clark) kishte çelësin...



E premte, 26 mars

Reagimi për sulmet në Kosovë nuk ishte shumë i mirë. Përveçse Harriers-at nuk kishin gjuajtur objektivat e tyre, TLAM-ët tanë (predhat për sulm tokësor Tomahawk) nga Splendid-it gjithashtu kishin dështuar. Yank-ët që na i shitën nuk ishin fare të kënaqur për këtë. Unë sugjerova që të thoshim se ishte një operacion i përbashkët dhe të mos hynim në detajet se kush bëri dhe kë pjesë të operacionit. Pasqyrimi i samitit po shkonte mirë, por sigurisht i shkurtuar pak nga Kosova. Rrugës së kthimit bëme shakatë e zakonshme për udhëheqësit e tjerë...

E hënë, 17 maj

T. B ishte i bindur se të paktën duhet të kërcënonim me përdorimin e forcave tokësore dhe të bënim përgatitje, përndryshe Millosheviçi do të mendonte se ai mund të rrinte aty derisa vullneti ynë të dobësohej. I thashë se ai sot duhej të fliste me Schoeder-in, sepse nesër ai duhej të ishte te NATO dhe do të ishte fokusi kryesor i mediave për atë ditë, dhe ne duhej ta bënim të ndryshonte qëndrim. Në Tiranë ne vizituam kampin e refugjatëve dhe një çift pleqsh që ishin shumë të prerë dhe të drejtpërdrejtë, por gjithashtu edhe shumë prekës për mënyrën sesi po jetonin. Fëmijët ishin nxirë nga dielli dhe ishin të gëzuar, dukej se kishin mjaftueshëm për të ngrënë, megjithëse brenda tendave ishte vapë dhe zagushi.

Nënat dukej se e kishin më të vështirë. Një grua na ndali dhe tha se burri i saj ishte kthyer me 4 brinjë të thyera. Ua kishin marrë të gjitha paratë dhe ata kishin lënë pas të afërm që ata e dinin se ishin vrarë apo përdhunuar.

T. B përçoi pak nga ai mesazhi: "Ju do të ktheheni në shtëpi" dhe foli për nevojën thelbësore për fitoren e njerëzores. T. B kishte menduar ta provonte prapë me B. C , t'i thoshte se tani ishte me të vërtetë i shqetësuar se po mbeteshim pa strategji përveç sulmit ajror dhe Millosheviçi thjesht do priste derisa neve të na mbaroheshin mundësitë. Ai e dinte se sa më shumë të bombardonim, aq më shumë civilë do të vrisnim dhe me kalimin e kohës vullneti i partnerëve tanë do të thyhej. Refugjatët nuk do të ktheheshin nëse ai vazhdonte të qëndronte aty, dhe ne nuk kishim



për ta hequr prej aty pa të paktën kërcënimin realist të trupave tokësorë. Pak para mesnate, John Sawers më zgjoi për të më informuar mbi një telefonatë “shumë të vështirë” mes B. C dhe T. B. Ata kishin folur për më shumë se një orë dhe 5-10 minutat e para ishin zënë me Bill-in, të cilit i kishte kërcyer damari. Ai i kishte parë raportimet nga Mbretëria e Bashkuar dhe gjërat në Shtetet e Bashkuara dhe ai “e dinte se çfarë po ndodhte, se ishte e qëllimshme dhe duhej të ndalej”. Ai tha se mund të shkonte me median britanike dhe me publikun, por “kishte një çmim për të paguar dhe ti do ta paguash”. John-i tha se ai qartësisht po sugjeronte se unë me qëllim kisha folur me median kundra tij për të ngritur lart T. B. T. B protestoi aq sa mundi. Ai tha se ishte i tmerruar nga ideja se ata mund ta shkonin ndërmend që ne

mund t'i vinim atij pengesa kur ai e drejtonte këtë gjë, së cilës B. C iu përgjigj se “në këtë rast po ndodh pa dijeninë tënde”- që nënkuptonte se ishte edhe më keq. John-i tha se ai nuk kishte thënë emra, por ishte e qartë se për kë e kishte fjalën. Ai tha se kurrë nuk e kishte dëgjuar kaq të inatosur dhe T. B ishte pak i habitur. Në thelb, megjithatë, B. C dukej se po lëvizte. Ai ndante mendimin e T. B, se opsioni i d' Alema-s mund të ishte një mënyrë për të hequr opsionin e trupave tokësorë. T. B e tha shkoqur: “Kishim një pushim 48 orësh, ndërsa binim dakord për një UNSCR të re, pastaj nëse Millosheviçi nuk bindej, bazuar në 5 kërkesat e NATO-s, ne do të bombardonim sërish dhe planifikonim për trupa tokësore”. Bill-i e pëlqeu si ide.



Tony Blair  
bisedim me telefon  
me trupat ushtarake  
Britanike HQ në kufirin  
e Kosovës afër Shkupit  
3 Maj, 1999

E shtunë, 5 qershor

Julian (Braithwaite) telefonoi herët, pasi kishte udhëtuar drejt Maqedonisë me një ekip nga SHAPE, për bisedimet në Bllac. Kishte një problem. Serbët nuk donin të vinin tek vendi që ne kishim zgjedhur. Bisedimet duhej të fillonin në orën 9. Serbët nxorën një tjetër vend takimi dhe shumë jap-e-marr me ta. NATO ra dakord që ata mund të lëviznin. Ky mund të ishte fillimi i talljes së tij të zakonshme. Millosheviçi po kërkonte të nxirrte jashtë familjen. Reagimi im i menjëhershëm ishte të rrinim të qetë, por e ndërrova mendjen gjatë natës. Tani kishim të bënim me Millosheviçin klasik. Kishte bërë marrëveshjen në parim, pastaj na humbiste kohën me detaje në një mënyrë të atillë që e bënte të duhej sikur ai po fitonte në ato pika që po përcaktonte.

E diel, 6 qershor

Kishim një problem serioz. Serbët nuk tërhiqeshin pa një UNSCR. Rusët nuk negocionin për një UNSCR pa ndalur bombardimi. Dhe ne nuk e ndalnim bombardimin pa u tërhequr ata. Mike Jackson i tha T. B se ai nuk besonte që ata e kishin seriozisht dhe tha se “duhet t'u themi të pirdhen”. Ahtisaari sugjeroi që ai të shkonte atje dhe në analizën finale tha se ai do t'i telefononte Millosheviçit, t'i thoshte se KFOR-i duhej të futej në territor dhe më pas ne do të merrnim një UNSCR. T. B tha se ai druante, se Jackson-i ishte një ushtar shumë i mirë, por një negociator i dobët. Mua më pëlqente dhe është një karakter i fortë, por sedërmadh dhe i paduruar, dhe jo domosdoshmërisht i vetëdijshëm për ndryshimin midis asaj që ndodhte në realitet dhe çfarë kishte kuptim që t'i thuhej medias. Ajo që duhej të ishte e qartë ishte se të gjitha problemet vinin nga ana e serbëve dhe ndërkohë ne duhet të vazhdonim me bombardimin.

24 marsi 1999 dita e nisjes së sulmit të forcave të NATO-s kundër pushtimit serb në Kosovë.

*Për jetë falënderim, nder dhe respekt, për të gjitha ato vende dhe personalitete ndërkombëtare që kanë dhënë kontributin e tyre për këtë ditë.*

## Mbledhje e Komisionit për Punë të Jashtme

Ministri i Jashtëm, Hoxhaj, raportoi para anëtarëve të Komisioni për Punë të Jashtme. Theksohen aktivitetet e tij dhe të MPJ-së, plani i punës për këtë vit dhe prioritetet e Ministrisë.



Ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Enver Hoxhaj, për më shumë se dy orë rresht ka raportuar para anëtarëve të Komisioni për Punë të Jashtme, dhe u është përgjigjur pyetjeve të shtruara dhe shqetësimeve të ngritura për gjendjen e MPJ-së dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës.

Në pjesën e parë të raportimit të tij në Komision ministri Hoxhaj është përqendruar tek prioritetet e MPJ-së.

- Si prioritet të parë Hoxhaj ka përmendur anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Në këtë mes ai ka përmendur anëtarësimin e Kosovës në Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e duke e veçuar si fakt pozitiv që “pro” anëtarësimin kanë votuar edhe vende të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën. Për këtë vit, ne do të shtrojmë kërkesën për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Hoxhaj ka theksuar se nga 47 vende sa ka KE, 37 tanimë e kanë njohur Kosovën, prandaj, pengesë për anëtarësim nuk i sheh qeveritë e vendeve

anëtare të Këshillit, por deputetët të Asamblesë Parlamentare të KE-së, disa prej të cilëve herë herë shfaqin diskonim kundër vendit tonë.

- Prioritet të dytë ka përmendur konsolidimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës. Në këtë mes ai procesin e njohjeve ndërkombëtare për Kosovën e ka quajtur “ proces të pandalshëm, të pakthyeshem dhe të pacenueshëm”, duke përkujtuar 13 njohjet që kanë ndodhur gjatë vitit të shkuar, e duke pohuar se pesë deri në shtatë shtete tashmë janë në procedurë të njohjes së vendit tonë.

- Integrimet evropiane dhe euroatlantike, Hoxhaj i ka vlerësuar prioritet tjetër të MPJ-së. Në këtë plan ai është shprehur optimist për lidhjen e marrëveshjes së asocim - stabilizimit, si marrëveshjen e parë Kosovë -BE, sepse është shprehur Hoxhaj: “shumica e vendeve të botës na shohin siç na sheh BE-ja”

- Ndër prioritetet e ministrisë së tij Hoxhaj ka veçuar



bashkëpunimin rajonal, duke ua dorëzuar me këtë rast anëtarëve të Komisionit Protokollin për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, i cili pritet të nënshkruhet në një të ardhme jo të largët.

- Si prioritet të fundit, ndërkaq, ministri ka përmendur funksionalizimin e MPJ-së. Në këtë mes ka përmendur organogramin e ri të Ministrisë dhe kompletimin e stafit të Zyrës për lëshimin e vizave për vendet jashtë Zonës Shengen.

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, i cili e ka drejtuar takimin, e ka falënderuar ministrin Hoxhaj për këtë raportim, duke i përkujtuar atij ftesat e përsëritura, të cilave nuk u është përgjigjur sot e dhjetë muaj. Ai ka shfaqur brengosjen e tij për gjendjen e MPJ-së dhe të Shërbimit Diplomatik të Kosovës, për degradimin e vazhdueshëm të tyre, si dhe për mos përmbushjen e rekomandimeve të Kuvendit, në përfundim të interpelancës së ministri Hoxha para Kuvendit (më 11 tetor 2012). Ndërkaq, ka shtruar shumë pyetje për ministrin Hoxhaj për të kuptuar nëse ka gjasa për përmirësime në këtë dikaster të rëndësishëm.

Në të njëjtën linjë kanë qenë edhe nënkryetari i Komisionit Hydajet Hyseni, si dhe anëtarët: Sabri Hamiti e Skender Hyseni, kurse Berat Buzhala është treguar më i kursyer në pyetjet për ministrin. Pyetjet kanë pasur të bëjnë me funksionimin jo të mirë të ministrisë, me buxhetin e saj të shpenzuar pa kriter, me punësimin politik të individëve në këtë ministri (pa përfillur institucionin e konkursit dhe profesionalizmin e kandidatëve), si dhe me gradime arbitrare e pa kriter të stafit të MPJ-së dhe të atij të Shërbimit Diplomatik.

Anëtarët e Komisionit kanë pohuar madje se kanë informata që nga 600 kandidatët e testuar nga MPJ-a, shumica prej tyre me kualitete solide profesionale, nuk është pranuar asnjëri prej tyre, por janë pranuar kandidatë të tjerë në linja partiake e të grupeve të interesit. Është përmendur edhe çështja e fusnotës, e cila miratuar për tu përdorur në takimet rajonale, ka filluar të duket edhe nëpër dokumente të rëndësishme të BE-së.

Ka pasur vërejtje, ndërkaq edhe për paralajmërimin e marrëveshjes për krijimin e të ashtuquajturit "Asociacioni i komunave serbe në Kosovë", për përdorimin e termit eufemik "dialog" për bisedimet me Serbinë, të cilat është theksuar se tashmë po quhen "dialogu Beograd-Prishtinë". Është shfaqur brenga edhe për kakofoninë e politikës së jashtme të Kosovës dhe për përzierjen e kompetencave ndërmjet ministrit të Jashtëm dhe zëvendëskryeministrave të Kosovës, si dhe ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Integritetit Evropian.

Ministri Hoxhaj, duke i'u përgjigjur pyetjeve të shtruarat ka theksuar dinamikën e tij dhe të qeveritarëve të tjerë për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës dhe për lobimin për më shumë njohje. Ai është shprehur se politika e jashtme e Kosovës është në unison, pavarësisht aktorëve të ndryshëm që e ushtrojnë. Ai ka pohuar se marrëveshjet e arritura me Serbinë në procesin e dialogut në Bruksel janë ndërkombëtare, të cilat i ka quajtur shumë të rëndësishme për Kosovën dhe procesin e njohjeve. Hoxhaj ka pohuar faktin se janë testuar 600 kandidatë në ministrinë e tij, por ka mohuar se janë pranuar kandidatë pa konkurs.

## Dëgjimi publik lidhur me Projektligjin për deputetët

Delegatët e viteve 90-të: Ne duhet të gëzojmë të drejta të barabarta me deputetët e Kuvendit të pasluftës.



Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, kryesuar nga kryetari Armend Zemaj, mbajti dëgjim publik lidhur me Projektligjin për deputetët, në të cilin morën pjesë deputetë të legjislativave të kaluara, përfaqësues të Qeverisë, përfaqësues të Avokatit të Popullit, si dhe atyre të shoqërisë civile.

Fillimisht z. Armend Zemaj, sqaroi se ka filluar amendamentimi i Projektligjit për Deputetët, duke bërë edhe një rezymë për historinë e këtij ligji në legjislativat e kaluara. Ai përmendi mes tjerash edhe suspendimin e një pjesë të këtij ligji nga Gjykata Kushtetuese. Kosova shtoi Zemaj është vendi i vetëm në rajon që nuk ka Ligj për Deputetë dhe bëri krahasimin e këtij draft-ligji me ligjin e kaluar. Ligji ka pësuar ndryshime, theksoi Zemaj, duke përmendur beneficinet për deputetët. Në këtë draft-ligj nën-komisioni ka paraparë moshën 60 vjeçare për pensionim dhe se tani e kemi gjetur edhe gjuhën konkrete se kur fillon dhe kur përfundon mandati i deputetit.

Bazuar në këtë draft-ligj, deputetët do ta kenë vetëm imunitetin funksional dhe se roli i deputetit duhet të jetë sikurse që e kanë deputetët në rajon. Ë rëndësishme është se kemi arritur të kompletojmë historinë e legjislativit në vend, duke filluar nga viti 1990 e deri më tani. "Të gjithë deputetët e të gjitha legjislativave duhet të jenë të përfshirë në këtë projektligj", theksoi Zemaj.

Anëtarja e nën-komisionit Albulena Haxhiu, duke paraqitur qëndrimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje kritikoi pagat e deputetëve, të cilat sipas saj janë të larta, duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të qytetarëve të Kosovës, ndërsa këtë fakt ajo e quajti padrejtësi. Duke theksuar se është kundër privilegjeve të deputetëve dhe pensionimit të hershëm të deputetit, Haxhiu tha se moshë e pensionimit të deputetëve duhet të jetë moshë 65 vjeçare, ndërsa shtoi se deputetët e të gjitha legjislativave duhet të jenë të barabartë në këtë ligj.

Me këtë rast, folën edhe disa nga ish-deputetët, si dhe delegatët e legjislativave të viteve 90-ta: Selatin Novosella, Ilaz Ramajli, Ramadan Kelmendi, Bujar Gjurgjeala, Mark Krasniqi, etj. Më tej, diskutuan edhe përfaqësues të Lëvizjes Fol, si dhe zëvendës Avokati i Popullit, Basri Berisha.

Delegatët e viteve 90-ta, gjatë diskutimit të tyre insistuan që atyre t'u mundësohet të gëzojnë të drejtat të barabarta me deputetët e Kuvendit të pasluftës. "Kërkojmë që në këtë ligj të përfshihet edhe legjislativa e vitit 1990 me të gjitha këto të drejta të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës".

Ndërsa, përfaqësues të shoqërisë civile vlerësuan se në ligj duhet të ketë edhe dispozita ndëshkuese gjatë ushtrimit të detyrave të deputetit.

Anëtarët e nën-komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, theksuan se do të vlerësojnë komentet dhe sugjerimet nga diskutuesit, ndërsa presin të marrin vlerësimet e Ministrisë së Financave dhe të Komisionit për Buxhet. Ky projektligj do të përfundojë në afatin sa më të shkurtër kohor dhe do të procedohet në seancë plenare.



## Deputetët e Kosovës marrin pjesë në punimet e Këshillit të Evropës



Deputetët e Kuvendit të Kosovës, Hydajet Hyseni (PDK) dhe Vjosa Osmani (LDK) morën pjesë në takimin e Komisionit për Çështje Politike dhe Demokraci të Këshillit të Evropës, ku u diskutua për Rezolutën dhe Raportin e përgatitur nga raportuesi për Kosovën, Bjorn Von Sydow.

Në këtë takim, deputetët paraqitën pikëpamjet e institucioneve të Kosovës lidhur me tekstin e kësaj Rezolute dhe paraqitën një sërë vërejtjesh dhe rekomandimesh. Në këtë frymë u mirëprit propozimi që të intensifikohen kontaktet e drejtpërdrejta në mes të institucioneve të Kosovës dhe Këshillit të Evropës. Deputetët potencuan se mohimi i të drejtës për qasje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut i qytetarëve të Kosovës është mohim i të drejtave e lirive

themelore të njeriut. Ata po ashtu shtuan se njohja e Kosovës nga më shumë se 2/3 e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës është një realitet i pakthyeshem dhe anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë është vetëm çështje kohe.

Shqyrtimi në Komisionin për Çështje Politike dhe Demokraci i parapriu diskutimit dhe miratimit të Rezolutës për Kosovën në Asamblesë Parlamentare të KE-së. Rezoluta u miratua me 115 vota pro dhe 11 vota kundër, ndërkaq Rekomandimet u miratuan me 121 vota pro dhe 5 vota kundër. Gjatë qëndrimit në Strasburg deputetët e Kuvendit të Kosovës u takuan edhe me deputetë të shumtë të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

## Kërkesa për kthimin e Fondit të Pensioneve të Kosovës duhet të marrë rrugë institucionale

Mbledhja e Kuvendit të Kosovës, e datës 28.2.2013, e kryesuar nga kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi (një pjesë të mbledhjes e kryesoi nënkryetari Sabri Hamiti), trajtoi në pikën-debat parlamentar; “Kompensimin e pensionistëve për kontributet e dhëna deri në vitin 1999”, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.



Në emër të parashtruesit të këtij debati, **Teuta Sahatçija** theksoi se kontributet pensionale të qytetarëve të Kosovës deri në vitin 1999 janë derdhur në fondin pensional të Jugosllavisë, fond ky të cilin e ka trashëguar Republika e Serbisë. Pagesat e pensioneve për qytetarët e Kosovës janë ndërprerë në qershor të vitit 1999.

Për shkak të mosnjohjes së Republikës së Kosovës nga ana e Republikës së Serbisë dhe pengesave të shumta administrative që krijohen nga institucionet e drejtësisë serbe, pensionistët tanë janë të privuar nga shfrytëzimi i të drejtës së tyre legjitime për marrjen e pensionit, ndonëse kjo e drejtë i garantohet çdo pensionisti me të drejtat ndërkombëtare.

Ajo theksoi se rasti Grudiq dhe ai i Shaban Kelmendit, të cilët realizuan të drejtën e kompensimit të pensioneve nga Gjykata e Strasburgut hasi në vesh të shurdhër në Qeverinë e Kosovës, mirëpo ajo hapi rrugën që pensionistët kosovarë të kërkojnë të drejtën e tyre për kompensim të pensioneve. Këtë të drejtë atyre ua garanton Konventa e të drejtave të njeriut . Po kështu Gjykata e Strasburgut ka hedhur poshtë mbrojtjen e Serbisë se nuk mund t' u jepen pensionet qytetarëve kosovarë pasi nga viti 1999 në

Fondin Pensional të Serbisë nuk ka të hyra nga territori i Kosovës, ashtu si edhe arsyetimet të tjera. Në vijim ajo tha se Fondi Pensional i Serbisë u ka borxh pensionistëve kosovarë nga 1,5 deri 5 miliard euro.

Ministri i Punës dhe Mirëqenien Sociale **Nenad Rashiq**, në fjalën e tij tha se është e drejtë individuale dhe grupore e qytetarëve që të ankohen në gjykatat ndërkombëtare për realizimin e të drejtave të tyre, por nuk është mënyra më e mirë për realizimin e së drejtës për kompensim të pensioneve. Ndërkaq, pensionistët nuk po konsultohen me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai propozoi që të bëhet një rekomandim lidhur me këtë çështje, e cila do t' i drejtohej Baroneshës Eshton që të dilet nga kjo situatë.

Deputeti **Shaip Muja** (PDK) theksoi se kjo temë është shumë e ndjeshme. Serbia, tha ai, duhet të kthejë fondet e pensionistëve dhe çështja e kompensimit të pensionistëve duhet të ngrihet pa dyshim në aspektin institucional dhe nuk duhet lënë në mëshirën e luftës individuale.

**Vjosa Osmani** (LDK) theksoi se në Gjykatën e Strasburgut mund të shkojë çdo qytetar, përkatësisht duhet të shteren të gjitha mjetet juridike për kompensim të pensioneve. “Mos i mashtroni



pensionistët që të mos shkojnë në Gjykatë për të drejtat e tyre, sepse Serbia po kërkon, që pensionistët të ndërrojnë nënshtetësinë për të realizuar të drejtën e kompensimit. Pensionistët e Kosovës duhet të shfrytëzojnë të drejtën për kompensim, kjo e drejtë atyre nuk mund t'iu mohohet, pasi, dialogu nuk e mohon të drejtën për kompensim". Kjo e drejtë e tyre lind nevojën që të formohet një komision për këtë çështje.

**Ahmet Isufi (AAK)** theksoi se Fondi i pensioneve të Kosovës nuk është grabitur nga ana e ndonjë individi, por nga shteti i Serbisë, prandaj shteti i Kosovës duhet të kërkojë kthimin e këtij fondi, madje me kamatë, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike që të realizojë këtë të drejtë. Zgjidhja e kësaj çështjeje nuk mund të zgjidhet individualisht, ndaj Kosova duhet të formojë një komision për këtë çështje për të mundësuar realizimin e së drejtës së kompensimit të pensionistëve të Kosovës.



**Myzejene Selmani (AKR)** tha se kjo çështje është e të gjitha subjekteve politike të Kosovës. Kthimi i i pensioneve është e drejtë e qytetarëve, ndaj Qeveria e Kosovës duhet të jetë në mbrojtje të kësaj të drejte, përkatësisht realizimit të saj. Ajo u shpreh se pensionistët edhe individualisht mund t'iu drejtohen Gjykatës së Strasburgut. Gjatë debatit u tha se çështja e mos kompensimit të pensionistëve është shkelje drastike e të drejtave

individuale e kolektive të pensionistëve, sepse fjala është për mjete të plaçkitura nga Serbia. Dominonte mendimi se kjo çështje të zgjidhet në mënyrë kolektive dhe në mënyrë të organizuar e institucionale. Kërkohej që të formohet një mekanizëm përkatës për të ndihmuar pensionistët për realizimin e kësaj të drejte, si dhe krijohej një fond që do të ndihmonte këtë çështje.

Në përfundim të debatit deputetët aprovuan këto rekomandime:

Duke pasur parasysh gjendjen e pensionistëve të Kosovës dhe nevojën që ata të kompensohen sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe të gjitha grupet tjera parlamentare, pas harmonizimit të mendimeve, i propozojnë Kuvendit që nga Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë:

1. Në afat prej dy javësh të formojë Komisionin Profesional, të përbërë nga juristë me njohuri për të Drejtat e Njeriut dhe përfaqësues të institucioneve të Kosovës që merren me çështjen e pensioneve.

2. Komisioni të mbledhë dokumentacionin e nevojshëm dhe të ofrojë këshilla juridike falas për të gjithë pensionistët që kërkojnë kompensim nga Serbia për kontributet e dhëna pensionale duke iniciuar raste në Gjykatën Evropiane.

## Veprimtaritë e Kuvendit

### Legjislacioni

Detyrat kryesore të Kuvendit janë shqyrtimi, debati dhe miratimi i legjislacionit.

Kuvendi formon forumin publik, ku përfaqësuesit e zgjedhur të popullit diskutojnë, debatojnë dhe japin kontributin e tyre për shqyrtimin dhe miratimin e projektligjeve (Salla e mbledhjeve plenare). Ky forum përveç projektligjeve, miraton edhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe aktet normative me fuqi ligjore të Këshillit të Ministrave, që kërkojnë aprovimin e Kuvendit.

### Buxheti i Shtetit



Sipas Kushtetutës, sesioni i vjeshtës nuk mund të mbyllet përpara se Kuvendi të miratojë ligjin për buxhetin e shtetit për vitin e ardhshëm. Kryeministri ia paraqet Kuvendit këtë projektligj gjatë seancës plenare.

Ligji për buxhetin e shtetit hartohet në bazë të parimeve të sanksionuara në procesin legjislativ, të përcaktuar nga Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Meqenëse ky ligj prek të gjithë veprimtarinë shtetërore, ai diskutohet nga pothuaj të gjitha komisionet parlamentare, sipas përgjegjësiave dhe në bashkëpunim me institucionet qendrore përkatëse. Në fund të këtij diskutimi, komisionet parlamentare hartojnë një raport drejtuar Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, i cili me pas paraqet raportin përfundimtar mbi buxhetin e shtetit në seance plenare.

### Kontrulli Parlamentar



Kontrulli parlamentar është një ndër përgjegjësitë më të rëndësishme të Kuvendit. Ai realizohet nëpërmjet këtyre veprimtarive:

**Pyetjet:** Sipas Kushtetutës, Kryeministri dhe çdo anëtar tjetër i Këshillit të Ministrave është i detyruar t'u përgjigjet interpelancave dhe pyetjeve të bëra nga deputetët brenda tri javëve nga data e paraqitjes së tyre.

Pyetjet u drejtohen ministrave për të marrë informacion lidhur me një ose disa çështje të caktuara. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, me kërkesë të komisioneve parlamentare, japin shpjegime dhe informojnë për çështje të ndryshme të veprimtarisë së tyre për sa e lejon ligji.

**Interpelanca:** Çdo deputet, një grup deputetesh ose grup parlamentar ka të drejtë të kërkojë zhvillimin e një interpelance. Ashtu sikundër edhe pyetja, interpelanca i drejtohet Kryeministrit dhe çdo anëtar tjetër të Këshillit të Ministrave, i cili është i detyruar t'i përgjigjet asaj brenda tri javëve nga data e paraqitjes. Rregullorja e Kuvendit jep këtë përkufizim për interpelancën: "Interpelanca është kërkesa me shkrim për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave, lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tij".



**Mocioni për debat:** Një kryetar grupi parlamentar ose një grup prej 5 deputetesh kanë të drejtë të paraqesin një mocion, me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për një çështje të caktuar ose për marrjen e një vendimi, bërjen e një deklarate ose rezolute. Në përfundim të debatit, Kuvendi duhet të marrë një vendim të caktuar, mund të bëjë një deklarate ose të miratojë një rezolutë.



**Mocioni i besimit:** Mocioni i besimit i paraqitur nga Kryeministri votohet jo më parë se të kenë kaluar 72 orë nga debati për të, me përjashtim të një marrëveshje të mundshme të grupeve parlamentare. Në rast se mocioni i besimit refuzohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi brenda 15 ditëve zgjedh një Kryeministër tjetër.



**Mocioni i mosbesimit:** Ky mocion mund të bëhet vetëm ndaj Kryeministrit dhe duhet të nënshkruhet nga të paktën 1/5 e deputeteve. Votimi i mocionit të mosbesimit nuk mund të bëhet pa kaluar 3 ditë nga paraqitja e tij. Në rast se mocioni i mosbesimit miratohet nga shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kuvendi brenda 15 ditëve zgjedh një Kryeministër tjetër. Në rastet e miratimit të përbërjes së Këshillit të Ministrave dhe programit politik të tij, të ndryshimeve në përbërjen e tij, si dhe në rastet e mocionit të besimit ose të mosbesimit, votimi në Kuvend bëhet kurdoherë nominal. Kryetari i Kuvendit i thërret një nga një deputetet me emër dhe i kërkon të prononcohen, duke u përgjigjur "pro", "kundër", "abstenim".

## Procesi Ligjvënës



Si një Projektligj bëhet Ligj

Sipas Kushtetutës, të drejtën për të paraqitur projektligje e gëzon Këshilli i Ministrave, çdo deputet i Kuvendit, si dhe 20 mijë zgjedhës. Diskutimi i projekt-ligjeve në seancë plenare bëhet në përputhje me rendin e përcaktuar nga kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit, i cili përgatitet në mirëkuptim nga Byroja e Kuvendit.

Përpara se projektligji të kalojë në seancë plenare ai shqyrtohet nga komisionet parlamentare përkatëse. Sipas shqyrtimit, komisioni parlamentar përgatit një raport, i cili ose propozon me argumentet përkatëse miratimin e projektligjit, propozon ndryshime (amendamente) për nën të caktuara të projektligjit, ose e kundërshton projektligjin dhe e kthen atë mbrapsht për të hartuesi. Komisioni i Çështjeve Kushtetuese dhe Ligjore i shqyrton të gjitha projektligjet dhe jep mendim për përputhshmërinë e tyre me Kushtetutën.

Pas miratimit të projektligjit, ai i dërgohet Presidentit të Republikës, i cili duhet ta shpallë atë brenda 20 ditësh nga paraqitja e tij. Presidenti ka të drejtë ta kthejë për rishqyrtim ligjin në Kuvend vetëm një herë. Në rast se presidenti nuk e shpall ose nuk e kthen ligjin për rishqyrtim brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij, atëherë ligji quhet i shpallur. Kushtetuta parashikon që ligji hyn në fuqi jo më pak se 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Përjashtim bëhet vetëm në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast emergjence dhe nevojë kur Kuvendi vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve dhe Presidenti i Republikës jep pëlqimin, ligji hyn në fuqi menjëherë vetëm pasi të jetë njoftuar publikisht.

## Mbledhjet e Komisioneve Parlamentare



Çdo komision parlamentar harton kalendarin e veprimtarive të tij në përputhje me kalendarin e punimeve të Kuvendit. Zakonisht mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare zhvillohen në kohë të ndryshme, me qëllim që deputetët të mund të marrin pjesë si në takimet e komisioneve parlamentare, ashtu edhe në seancat plenare.

Mbledhjet e komisioneve janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur komisioni vendos t'i zhvillojë ato me dyer të mbyllura. Anëtarët e Këshillit të Ministrave edhe ekspertë të ftuar shpesh marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve. Vendimet e komisioneve parlamentare merren me shumicë votash. Deputetët që janë në pakicë gjatë këtij votimi, kanë të drejtë të shprehin opinionet e tyre rreth këtyre çështjeve gjatë seancës plenare.

### Seancat Plenare

Pas diskutimeve nga të gjitha komisionet parlamentare përkatëse, paraqitet raporti përfundimtar i projektligjit për diskutim, në bazë të rendit të kalendarit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare, të cilat janë të hapura. Debati mbi projektligjin fillon me paraqitjen e tij nga hartuesi, i cili paraqet argumentet që mbështesin projektligjin. Më pas, komisionet parlamentare, që shqyrtuan projektligjin, paraqesin raportet e tyre. Kryetari i Kuvendit i jep fjalën për diskutim deputetëve dhe përpiket të harmonizojë sa të jetë e mundur pjesëmarrjen në debat të çdo grupi parlamentar.

- Përpara se debati për miratimin e projektligjit në parim të mbyllet, kryetarët e grupeve parlamentare kanë të drejtën të marrin fjalën.- Për çështje procedurale fjala jepet menjëherë.



Sipas Rregullores së Kuvendit, çështjet procedurale ngrihen nga deputetët rreth zbatimit të Rregullores së Kuvendit. Si çështje procedurale, mund të përmenden ndryshimi i rendit të ditës, vërejtje për vendimmarrjen ose procedurën e votimit. Sipas Rregullores së Kuvendit, procedurat e votimit klasifikohen në dy kategori: votim i hapur dhe votim i fshehtë. Votimi është përgjegjësi vetjake e çdo deputeti; e drejta e votës nuk mund të delegohet. Votimi i fshehtë kryhet në rastet kur ai ka të bëjë me individët ose kur kërkohet nga një grup prej pesë deputetësh. Nuk mund të miratohen me votim të fshehtë çështjet që kanë të bëjnë me ligjet financiare, buxhetin e shtetit ose vendime të tjera me efekte financiare.

Sipas Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, çdo projektligj votohet tri herë: në parim, nën për nen dhe në tërësi. Pas miratimit në parim, projektligji votohet nën për nen me gjitha ndryshimet e propozuara nga komisioni përkatës në raportin e tij. Gjatë procesit të votimit, çdo deputet, grup parlamentar ose Këshilli i Ministrave mund të paraqesin amendamente. Pas votimit nën për nen, projektligji votohet në tërësi, procedurë e cila është faza e fundit e votimit të ligjit në Kuvend. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të 1/5 së deputeteve, Kuvendi, në raste të veçanta, mund të diskutojë dhe miratojë projektligje me procedurë të përshpejtuar.



## Kryeparlamentari Krasniqi priti ministrin e Jashtëm të Pakistanit, z. Malik Amad Khan



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në takim ministrin Shtetëror të Punëve të Jashtme të Pakistanit, z. Malik Amad Khan, me të cilën bisedoi për zhvillimet aktuale në Kosovë dhe marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve. Duke i uruar mirëseardhje në Kosovë, kryetari Krasniqi i shprehu ministrit pakistanez falënderimet për njohjen e shtetit të Kosovës nga Pakistani dhe për të gjithë mbështetjen që ky vend mik i ka dhënë Kosovës edhe përpara njohjes, veçanërisht gjatë viteve 2001-2002 në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Kryetari i Kuvendit çmoi, gjithashtu, ndihmën pakistaneze nëpërmjet prezencës ndërkombëtare në Kosovë, gjatë fazës së administrimit nga ana e misionit të OKB-së. “Jemi duke u përpjekur që të krijojmë sa më shumë miq dhe në këtë frymë, Pakistani e konsiderojmë vend mik”, tha kryetari i Kuvendit. Njohjen nga Pakistani dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet dy vendeve, kryeparlamentari Krasniqi i konsideroi të një rëndësie të veçantë, ndërsa shprehu interesimin dhe gatishmërinë për të zgjeruar marrëdhëniet edhe ndërmjet dy parlamenteve respektive. Ministri pakistanez Khan, nga ana e tij, pasi shprehu kënaqësinë që gjendet për vizitë në Kosovë, theksoi nevojën e kultivimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe mori përsipër angazhimin për të ndihmuar në vendosjen e marrëdhënieve ndër parlamentare. Duke konfirmuar mbështetjen e shtetit të tij për Kosovën, ministri Khan tha se njohja e saj është mirëpritur nga institucionet dhe populli pakistanez. Ai shtoi se Kosova si shtet i ri, ka sfidat e saj, por ka edhe përparësitë, sepse mund të mësojë nga gabimet e të tjerëve.

## Kryeparlamentari Krasniqi priti ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, z. Ismet Ylmaz



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dr. Jakup Krasniqi, më 8 shkurt 2013, priti në një takim ministrin e Mbrojtjes së Turqisë, z. Ismet Ylmaz. Zhvillimet aktuale politike dhe ekonomike në vend, ndërtimi i raporteve fqinjësore, si dhe pozita e Forcës së Sigurisë së Kosovës, ishin tema e diskutimit në këtë takim. Duke iu uruar mirëseardhjen delegacionit nga Turqia, kryetari i Kuvendit, dr. Jakup Krasniqi, fillimisht tha se Kosova ka marrëdhënie të mira me shumicën e vendeve të BE-së si dhe vendet e rajonit. Kosova ka raporte të shkëlqyera me Turqinë, me theks të veçantë ato parlamentare që ekzistojnë ndërmjet dy shteteve. Turqia ka mbështetur në vazhdimësi Kosovën, duke vënë në pah edhe përkushtimin në rrugën drejt Pavarësisë së Kosovës, si dhe për angazhimin e këtij vendi drejt njohjeve të Kosovës si shtet. Kryeparlamentari Krasniqi theksoi se marrëdhëniet mes Turqisë dhe Kosovës duhet të fuqizohen edhe më shumë, nga viti në vit. Duke folur edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës, ai theksoi se vendi ynë është duke e ndërtuar ushtrinë e ardhshme të Kosovës dhe ka nevojë për ndihmë dhe mbështetje në këtë proces. Ministri i Mbrojtjes së Turqisë, Ismet Ylmaz, duke falënderuar kreun e Kuvendit për mikpritje tha se Turqia do ta përkrah në vazhdimësi Kosovën, duke përmendur me këtë rast angazhimin e këtij vendi në rrugën drejt njohjes së Kosovës shtet. Ministri Ylmaz tha se shkalla e bashkëpunimit mes Kosovës dhe Turqisë do të rritet edhe më shumë në të ardhmen duke theksuar se vendi i tij e përkrah anëtarësimin e Kosovës në BE dhe në NATO.

## Mirënjohje për kontributin e z. De Marnhac dhe të Francës në zhvillimet e gjithanshme në Kosovë.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim përcjellje, z. Xavier De Marnhac, kryesues i Misionit të EULEX-it në Kosovë, në përfundim të mandatit të tij. Me këtë rast kryekuvendari Krasniqi i shprehu mirënjohje z. De Marnhac për kontributin e tij në krye të këtij misioni, por edhe më parë si komandant i KFOR-it. Kreu i legjislativit të vendit, njëkohësisht shprehu mirënjohje edhe ndaj shtetit të Francës për gjithë atë që ka bërë e bën për të mirën e Kosovës.

Z. Xavier De Marnhac, pasi falënderoi për pritjen që iu bë, theksoi se ka qenë i angazhuar me përkushtim të madh në këtë mision, duke pasur gjithnjë para sysh që funksioni dhe puna e EULEX-it të jetë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. Ai tha se me gjithë vështirësitë, gjatë këtyre viteve është bërë punë e frytshme në Kosovë. Duke folur për rezultatet që i ka shënuar Kosova, ai vlerësoi sidomos përfundimin e fazës së mbikëqyrjes ndërkombëtare të Kosovës. Në këtë frymë ai uroi kryekuvendarin dhe shtetin e Kosovës për të arritura të mëtejme në të gjitha aspektet.

Në fund të takimit, kryetari i Kuvendit Krasniqi, në shenjë kujtimi, i dhuroi një dhuratë modeste, z. De Marnhac.

## Kryeparlamentari Krasniqi priti shefin e ri të EULEX-it, Bernd Borchardt



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në takim shefin e ri të EULEX-it, Bernd Borchardt, me të cilin bisedoi për bashkëpunimin e deritashëm, frytet e këtij bashkëpunimi dhe mundësitë e thellimit të mëtejme të tij.

Pasi e uroi z. Borchardt për detyrën e re në krye të misionit të EULEX-it, kryetari Krasniqi çmoi ndihmën që EULEX-i i ka dhënë Kosovës gjatë gjithë viteve të misionit të tij, por kërkoi që kjo mbështetje të rritet edhe më tej në të ardhmen, si në fushën e sundimit të ligjit, ashtu edhe në procesin e integriteteve euro-atlantike. Shefi i EULEX-it, Bernd Borchardt, duke u shprehur i kënaqur me rolin e Kuvendit të Kosovës, tha se ndihet i gëzuar që po kthehet sërish në Kosovë. Ai tha se është me shumë rëndësi që EULEX-i të vazhdojë të punojë ngushtë me institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë.

“Ne jemi në partneritet dhe me partneritet vijnë edhe përgjegjësitë. EULEX-i është i gatshëm që ta bëjë pjesën e vet. EULEX-i luan rol të rëndësishëm në përfshirjen e BE-së në Kosovë, si procesi i liberalizimit të vizave dhe dialogu i strukturuar i sundimit të ligjit. Kjo është në të mirë të të gjitha komuniteteve”, theksoi Borchardt.



## Bashkëpunim i ngushtë Kuvend - USAID



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, zhvilloi një takim më 25.01.2013, me një delegacion zyrtarësh të lartë të USAID-it, nga Washingtoni, z.Keith Schultz dhe z.Mike Henning, gjatë të cilit u diskutua lidhur me të arriturat e deritashme në lëmin e bashkëpunimit ndërmjet USAID-it dhe Kuvendit, si dhe për nevojat prioritare që ka Kuvendi, në të cilat do të mund të kontribuojë edhe në të ardhmen kjo agjenci prestigjioze.

Kryekuvendari Krasniqi, pasi falënderoi delegacionin për këtë vizitë, shprehu mirënjohje për bashkëpunimin e deritashëm, duke theksuar se ndërmjet Kuvendit dhe USAID-it që nga viti 2001 është zhvilluar një bashkëpunim i ngjeshur, nga i cili Kuvendi i Kosovës ka përfituar në shumë aspekte, sidomos në fushën e legjislacionit, ngritjen e kapaciteteve të administratës, si dhe në fushën e transparencës etj.

Zyrtarët e USAID-it vlerësuan lart bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve, duke theksuar se në shumë fusha janë arritur rezultate të mëdha. Ndër të arriturat ata përmendën edhe rezultatet në krijimin e lidhjeve të afërta të Kuvendit me shoqërinë civile, funksionimin e ueb faqes së Kuvendit, hapjen e Qendrës së Vizitorëve etj.

Bashkëbiseduesit ishin të një mendimi, se është e nevojshme të bëhet më shumë sidomos kur është fjala për mbikëqyrjen parlamentare ndaj ekzekutivit, të zbatimit të ligjeve, të agjencive që formon Kuvendi etj. Detyrë me rëndësi në kuadrin e mbikëqyrjes është veçanërisht çështja e mënyrës së shpenzimit të buxhetit, përkatësisht secili komision t'i kushtojë kujdes këtij segmenti në fushat përkatëse që ka në fushëveprimin e vet.

## Institucioni i Avokati të Popullit duhet të ketë pavarësi politike në veprimtarinë e tij, në mbështetje të ligjit



Roli dhe funksionimi i institucionit të Avokatit të Popullit, si një strukturë e rëndësishme ndërmjet qytetarit dhe administratës, ishte tema kryesore e takimit të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, me avokatin e popullit të Shqipërisë, z. Igli Totozani dhe avokatin e popullit të Kosovës, z. Sami Kurteshi. Duke iu uruar mirëseardhje dhe njëherësh duke i përgëzuar për bashkëpunimin e ndërsjellë, kryekuvendari Krasniqi theksoi se gjithnjë bën përpjekje që të përkrahë të gjitha institucionet që i përgjigjen Kuvendit, në mënyrë që ato t' i shfrytëzojnë të gjitha të drejtat që ua garantojnë ligjet. Funksioni që kryejnë avokatët e popullit nuk është i lehtë, sidomos në shtetet në tranzicion. Në vijim kryetari Krasniqi theksoi se angazhohet që institucioni i Avokatit të Popullit të gëzojë pavarësi politike në veprimtarinë e tij, në mbështetje të ligjit. "Kemi përgjegjësi të dëgjojmë me durim hallet e qytetarëve. Kërkesat e tyre nuk janë të mëdha, ndaj duhet të dëgjojen ata, e kur veprohet kështu, atëherë qytetarët ndiejnë një sodisfaksion", u shpreh ai.

Z. Igli Totozani theksoi se ndihma e parlamentit ndaj institucionit të Avokatit të Popullit është me rëndësi shumë të madhe. Avokati i Popullit është institucion i veçantë, ndaj edhe duhet të kuptohet funksioni i tij. Njëzërit duhet të mësohen me këtë realitet, por kjo nuk është e thjeshtë.

Të dy avokatët e popullit theksuan se ballafaqohen me sfida në veprimtarinë e tyre, por gëzojnë përkrahjen e parlamente përkatëse. Sami Kurteshi vlerësoi lart ndihmën e kryetarit Krasniqi, por edhe të disa komisioneve parlamentare, pa kontributin e të cilëve vështirë se do të arriheshin rezultatet e shënuara.

## Dy komisione parlamentare pritën delegacionin parlamentar nga Holanda.



nëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme dhe ata të Komisionit për Integritime Evropiane, kanë pritur delegacionin parlamentar nga Mbretëria e Holandës, në përbërjen e të cilit ishin; kryetari i Senatit, Fred de Graaf, Geert Jan Hamilton, Sekretar i Përgjithshëm i Senatit, si dhe znj. Saskia van Genugten, zyrtare e Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, Mbrojtje dhe Bashkëpunim për Zhvillim. Gjithashtu ishin të pranishëm ambasadorët e të dy vendeve: Robert Boch dhe Nexhmi Rexhepi.

Duke i uruar mirëseardhje në Kosovë, kryetari i Komisionit për Integritime Evropiane, Lutfi Haziri, ka vlerësuar mbështetjen e pakursyer të Holandës për Kosovën dhe popullin e saj. Ai ka folur për punën e rëndësishme që bëjnë këto dy komisione parlamentare për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës dhe përgatitjen e vendit për procesin e integritimeve evropiane. Haziri ka theksuar se Kosova po e pret me padurim vendimin e Këshillit të Ministrave të BE-së për iniciimin e marrëveshjes së stabilizim- stabilizimit. Ai tutje ka folur për nevojën urgjente të qytetarëve të Kosovës për liberalizimin e vizave me vendet e BE-së, duke shtuar se këta hapa të pritshëm të BE-së do të ndikojnë pozitivisht edhe për investimet e huaja në ekonominë e Kosovës edhe për sa i përket shkollimit të rinjve tanë nëpër institucionet arsimore dhe shkencore të vendeve të BE-së.

Kryetari i Senatit të Mbretërisë së Holandës, Fred de Graaf, ka vlerësuar të arriturat e Kosovës pas shpalljes së pavarësisë, duke çmuar sidomos vullnetin e të rinjve të Kosovës për dije, punë dhe kreativitet. Ai ka theksuar se e kupton padurimin e qytetarëve të Kosovës për t'u bërë pjesë e BE-së, por ka theksuar gjithashtu se Kosova duhet t'i plotësojë me shumë mund standardet për procesin e integritimeve evropiane, ta cilat ka pranuar ai, po bëhen gjithnjë e më të vështira për vendet pretendente për anëtarësim në BE. Ai ka porositur përfaqësuesit e legjislativit të Kosovës që Kuvendin ta bëjnë institucion të besueshëm të qytetarëve dhe sa më mirë dhe sa më shpejtë tu përgjigjen rregullave strikte të BE-së.

Edhe diskutuesit e tjerë në këtë takim: Sabri Hamiti, Donika Kadaj-Bujupi, Vjosa Osmani, Alma Lame, Suzana Novobërdaliu dhe Emilia theksuan nevojën e Kosovës për integritime evropiane, duke u përqendruar sidomos në nevojën e ngutshme për liberalizimin e vizave. Kosova historikisht dhe politikisht ka qenë dhe është evropiane, prandaj duhet të bëhet e tillë edhe politikisht, ndryshe të rinjtë tanë po izoloohen pa të drejtë nga proceset evropiane, është thënë në takim, në të cilin është pohuar gjithashtu se të rinjtë e Kosovës kanë nevojë për lëvizje të lirë; për marrjen e djes gjithandej nëpër vendet e BE-së dhe për realizimin e tyre në Kosovë.



## Çekia rikonfirmon mbështetjen për Kosovën dhe aspiratat e saj euro-atlantike



Nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Pragë, gjatë të cilës ka zhvilluar takime të ndara me Komitetin për Politikë të Jashtme dhe Mbrojtje në Senatin e Republikës së Çekisë dhe Komisionin për Çështje Evropiane të Parlamentit të Çekisë.

Në takimin me senatorin Jaroslav Sikaček, njëkohësisht nënkryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, z. Haliti e falënderoi atë për pritjen dhe vlerësoi se Çekia paraqet vendin model të transformimit në proceset demokratike. Haliti po ashtu tha se qytetarët e Kosovës i janë mirënjohjes popullit dhe institucioneve çeke, për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë në ndërtimin Kosovës moderne.

Më tej, nënkryetari Haliti deklaroi se Kosova është faktor paqeje e stabiliteti dhe për pesë vjet u transformua në demokraci moderne multi etnike. Në këtë takim, Haliti foli edhe për progresin që Kosova ka bërë prej shpalljes së pavarësisë dhe për të arriturat në procesin e shtet ndërtimit dhe integrimeve evropiane.

Senatori Jaroslav Sikaček, ndërkaq, pasi i uroi mirëseardhje z. Haliti, shprehu gatishmërinë për bashkëpunim. Këtë vizitë ai e konsideroi si një mundësi për të avancuar bashkëpunimin dhe një mundësi të jashtëzakonshme për t'u njoftuar për së afërmi për zhvillimet në Kosovë. Më pas, senatori Sikaček shfaqti interesim për zhvillimet në Kosovë, por edhe siguroi që do të mbështes çdo nismë në kuadër të dinamizmit të marrëdhënieve bilaterale dhe bashkëpunimit parlamentar ndërmjet dy vendeve.

Nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Xhavit Haliti, është pritur edhe në Dhomën e Përfaqësuesve të Parlamentit Çek, ku është takuar me znj. Dana Vahalova, nënkryetare e Komisionit për Çështje Evropiane në Dhomën e Përfaqësuesve të Parlamentit të Çekisë. Duke i uruar nënkryetarit Haliti mirëseardhje në Parlamentin çek, znj. Vahalova shprehu gatishmërinë për mbështetjen e proceseve integruese nëpër të cilat po kalon Kosova, në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Të dy palët u pajtuan se duhet të kalohet në fazën e intensifikimit të bashkëpunimit mes institucioneve parlamentare të të dy vendeve, në planin bilateral dhe multilateral.

Në të dy takimet pala çeke siguroi se nuk do të mungojë mbështetja për Kosovën dhe aspiratat e saj euro-atlantike në mënyrë që ajo sa më shpejtë të bëhet anëtare në organizatat ndërkombëtare.

## Pyetjet pa përgjigje

Deputetja Albulena Haxhiu

Për ministrin e Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi

Mbi cilën bazë ligjore po implementoni të ashtuquajturin IBM në zonat në kufi me Serbinë? A është bërë demarkacioni?

Deputetja Alma Lama VV

Për kryeministrin e Kosovë z. Hashim Thaçi

Cila është sasia e parave që qeveria e Kosovës ka marrë nga shuma e premtuar dhe në cilët sektorë janë investuar këto para? A ka qeveria e Kosovës një pasqyrë të qartë financiare në lidhje me donacionet e premtuara në Bruksel?

Deputetja Ganimete Musliu PDK

Për ministrin e Diasporës z. Ibrahim Makolli

1- Në bazë të informacioneve që kemi ju keni marrë disa hapa konkrete në lidhje me organizimin e arsimit shqip në diasporë për çka bashkatdhetarët tanë janë shumë mirënjohës për një iniciative të tillë nga shteti i Kosovës.

Ministër a mund të na jepni disa sqarime rreth këtij procesi, që edhe ne të dimë se deri ku është arritur me procesin e realizimit të kësaj iniciative?

2- Në regjistrimet e fundit të popullsisë që është bërë në Kosovë , siç jemi në dijeni të gjithë nuk janë përfshirë qytetarët e Kosovës që jetojnë në diasporë. Duke pasur parasysh se tashmë kemi ambasada të akredituara në shumicën e vendeve dhe janë mundësitë për lehtësimin e procedurave të regjistrimit, çka është duke bërë ministria e diasporës për regjistrimin e qytetarëve që jetojnë jashtë Kosovës?





Ceremonia festive në kazermën “Adem Jashari”







## Fëmijët vizitë në Kuvend

